

Data 09.09.2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirëmbajtje e sistemit CRM dhe Billing”.”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT- 48614000-5 - Sistem i marrjes së të dhënave.

VLERA E FONDIT LIMIT:

- 117,982,224 (njëqind e shtatëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind e njëzet e katër) lekë, pa TVSH.
- 1,178,761.35 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pikë tridhjetë e pesë) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 09.09.2024 1 euro = 100.09 All.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020 i ndryshuar , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyetimit te meposhtem:**

Ne zbatim te Paragrafit 2, Pika 1, e Nenit 39 te LPP, Njesia e Prokurimit sqaron se, nuk ka perzgjedhur ndarjen ne Lote te procedures se prokurimit per arsye se kjo procedure eshte e pamundur teknikisht te ndahet ne kontrata te ndryshme sepse nga vete objekti i prokurimit kemi te bejme me nje sistem qendror i cili bazohet dhe karakterizohet nga nderlidhja e pashmangshme e disa zgjidhjeve teknologjike prodhuesish te ndryshem boteror, duke bere te mundur vetem Upgrade, zgjerim dhe permiresim te sistemit aktual. Ndarja ne lote do ta bente te pa ekezekutueshme kontraten pasi eshte nje sistem kompleks dhe i perqendruar.

**I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit 33, të ligjit 10091 datë 05.03.2009 i ndryshuar “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **117,982,224 (njëqind e shtatëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind e njëzet e katër)** leke pa TVSH.

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse (*Administrata tatimore*) dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar (*vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pikat 1, 2, dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e shërbimit dhe vlerën e konsiderueshme të fondit limit të kësaj kontrate, kompleksitetin e produkteve dhe shërbimeve, sasinë dhe cilësinë e tyre, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë arsye, OE

ofertues duhet te ketë disponibilitetin e duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera mesatare e xhiros për tre apo me pak vitet e fundit financiare te jete ne masën **117,982,224 (njëqind e shtatëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind e njëzet e katër)** leke pa TVSH.

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 13 pika 2: *“Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi”*.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe neni 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë afersisht sa 35 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomikë që ofrojnë këto lloje shërbimesh, pavarësisht rëndësisë dhe kompleksitetit të shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymën e konkurueshmërisë që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë/realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë rreth 35 % e vlerës (në vijimesi edhe me LLP të mëparshme) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do të jetë realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

---

22.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare (ISO), për të siguruar kontrollin e cilësisë dhe sigurinë mbi informacionin. Për këtë arsye, operatori ekonomik ofertues duhet të zotërojë Çertifikatat e mëposhtme të vlefshme në datën e hapjes së tenderit:

- a) **ISO 9001:2015 ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme).**
- b) **ISO 27001:2013 ose ekuivalente, për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme).**
- c) **ISO/IEC 20000-1:2018 ose ekuivalente, për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (e vlefshme).**

*Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.*

*Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes paraprake.*

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- **ISO 9001** per sistemin e menaxhimit te cilesise (te vlefshme), ose ekuivalente, te perditësuar, e cila duhet te jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen.

*Argumentimi:* Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. **ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”** – Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

- Certifikatën per menaxhimin e informacionit **ISO 27001** ose ekuivalente të perditësuar, e cila duhet te jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen.

*Argumentimi:* **ISO 27001:2013 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit”** – Ky standard është i nevojshëm për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky standard përfshinë kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës, me qëllim që informacioni të mbetet i sigurtë dhe të mos çënohet siguria e sistemeve të saj nga sulmet kibernetike. Ky standard është kërkuar në përputhje me objektin e prokurimit dhe Specifikimet Teknike pasi ky objekt prokurimi përfshinë implementimin, adaptimin, testimin, shpërndarjen dhe instalimin e të gjitha informacioneve teknike të sistemit.

- Certifikatën per menaxhimin e shërbimeve **ISO 20000-1** ose ekuivalente të perditësuar, e cila duhet te jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen.

*Argumentimi:* **ISO 20001:1 “Sistemi i menaxhimit të shërbimeve”**- Ky standart siguron qe operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektivisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi /distributori i autorizuar ose certifikatën e të drejtave të autorit për shitjen e produkteve software dhe ofrimin e shërbimeve të përfshira në këtë objekt prokurorimi në territorin e Shqipërisë. Në rast të paraqitjes së autorizimit të prodhuesit/distributorit te autorizuar, autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit të autorizuar si: telefon,fax,e-mail,website, kjo është e nevojshme për Autoritein Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Në rast te paraqitjes se Autorizimit te distributorit, duhet te

paraqitet edhe dokumentacioni qe verteton lidhjen me prodhuesin. Autorizimi të këtë edhe datën e leshimit përpara datës së zhvillimit të tenderit.

**Argumentimi:** *Autorizimi i prodhuesit është nje dokument i rëndësishëm, pasi përvecse tregon origjinën e mallrave/shërbimeve që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave/shërbimeve sipas kerkesave ne specifikimet teknike.*

*Për të garantuar me sukses përmbushjen e të gjithë kërkesave teknike gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, për të garantuar zgjidhjen e problemeve të paparashikuara që mund të hasë OE gjatë kryerjse së proceseve të punës deri në dorëzim të plotë të kontratës, nevojitet të kenë mbështetje nga prodhuesi i zgjidhjes për rastet e perballjes me situata të paparashikuara si dhe për zgjidhjen e problematikave të mundshme gjatë fazës së realizimit të projektit.*

*Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Për produktet software ose komponentet që ofrohen falas nga prodhuesi të cilat vetëm shpërndahen por nuk shiten, nuk është i nevojshëm autorizimi por mjafton që OE të përmendë emrin e komponentit, burimin ku do ta marrë psh website zyrtar, dhe një burim në internet ose dokument të vërtetueshëm nga AK ku përcaktohet që prodhuesi ose distributori i saj e ofron falas dhe lejon shërpndarjen për këdo.*

2.3.4 Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe manaxhimin me profesionalizëm të punës, **duhet te kete te punësuar jo me pak se 7 punonjës te fushes se teknologjise se informacionit (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj).** Gjithashtu, mbështetur në kërkesat e specifikimeve teknike dhe teknologjinë hardware dhe software të sistemit, operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka në stafin e nevojshëm IT, punonjës të kualifikuar me një nga kualifikimet e mëposhtme, minimalisht:

**I- Operatori ekonomik duhet të ketë personel te certifikuar që do të angazhohen në implementimin e projektit:**

- a. Të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar për Menaxhim Projektsh ose ekuivalent me 1 (nje) vit eksperience ne menaxhim projektsh me teknologji CRM/Billing.
- b. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar ITIL ose ekuivalent per sherbimet IT.

- c. Te paktën 2 (dy) Software inxhinier te certifikuar per zhvillim te aplikacioneve i cili ka minimum 3 vite përvojë ne zhvillim Oracle Java te softuerit CRM/Billing ose ekuivalent.
- d. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për administrimin e serverave në RHEL Linux ose ekuivalent.
- e. ekuivalent 1 (një) punonjës të certifikuar për administrim të serverave Windows ose ekuivalente.
- f. Te paktën 2 (dy) te certifikuar per menaxhim baze te dhenash me minimumi 5 vjet eksperience ose ekuivalent.

## **II- Për të vërtetuar stafin e mësipërm operatori Ekonomik duhet të paraqesë:**

- Certifikata përkatëse/Transkriptet përkatëse/Diplomat
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi, (duke marrë si reference data e hapjes se ofertave).
- Nje punonjes mund te kete nje ose me shume certifikime dhe te kryeje nje apo me shume nga funksionet e kerkuara.

**Sqarim :** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

**Shenim :** Sqarojme te gjithë operatorët ekonomik qe ne rast mosperputhje ndermjet versionit anglisht te DT dhe atij ne shqip, do te prevaloje versioni shqip i DT.

### **Lidhur me punonjesit e kerkuar argumentojme si vijon:**

1. Të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar për Menaxhim Projektsh ose ekuivalent me 1 (nje) vit eksperience ne menaxhim projektsh me teknologji CRM/Billing

**Argumentim:** Ky kriter garanton AK që operatori ekonomik ka në përbërje të tij stafin me aftësi profesionale në mënyrë që i gjithë projekti të realizohet konform të gjitha kërkesave dhe afateve të përcaktuara në DST dhe specifikimet teknike. Punonjësi i certifikuar si menaxher projekti ku te paktën 1(nje) vit me eksperience ne menaxhim projektsh me teknologji CRM/Billing garanton organizimin e njerzve dhe burimeve të OE për të patur zbatim të suksesshëm të projektit sipas standarteve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit CRM/Billing. Një menaxher projekti është përgjegjës për ndjekjen e të

gjithë ciklit të një projekti që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të programit.

1. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar ITIL ose ekuivalent për shërbimet IT.

**Argumentim:** Certifikimi për (ITIL) është një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit të suportit gjatë implementimit, në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të Autoritetit Kontraktor. Duke pasur një punonjës të certifikuar për ITIL, operatori ekonomik tregon përkushtim ndaj cilësisë dhe menaxhimit të shërbimeve IT në përputhje me standardet me të mira. Kjo ndihmon në sigurimin e një menaxhimi efektiv dhe të strukturuar të shërbimeve, duke përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë e ofruar.

2. Te paktën 2 (dy) Software inxhinier të certifikuar për zhvillim të aplikacioneve i cili ka minimum 3 vite përvojë në zhvillim Oracle Java të softuerit CRM/Billing ose ekuivalent.

**Argumentim:** Kriteri garanton AK për aftësitë profesionale të punonjësve që ka OE. Disponimi i 2 (dy) Software inxhinier të certifikuar për zhvillim të aplikacioneve garanton implementimin e të gjithë specifikimeve të kërkuara nga AK lidhur me platformen CRM/Billing. Gjithashtu ky specialistë garantojnë vijueshmerinë normale të punës për gjatë gjithë periudhës së kontratës. Disponimi i 2(dy) programues/zhvillues minimum 3 vite përvojë në zhvillim Oracle Java të softuerit CRM/Billing garanton ndërhyrje të përgjegjshme në bazën e të dhënave si dhe performancë maksimale gjatë gjithë shtrirjes së kontratës pavarësisht shtimit të sasisë së të dhënave në të, pasi sistemi CRM/Billing është një sistem i cili përpunon miliona të dhëna të cilat rriten me miliona rekorde çdo muaj.

3. 1 (një) punonjës të certifikuar për administrimin e serverave në RHEL Linux ose ekuivalent.

**Argumentim:** Për të garantuar mirëmbajtjen e hardware-t (serverave) me sistem operimi Linux, në skuadër nevojitet një punonjës i certifikuar në administrimin e tyre. Certifikimi për administrimin e serverave në RHEL (Red Hat Enterprise Linux) është i rëndësishëm për disa arsye që ndihmojnë në përmirësimin e aftësive profesionale dhe në sigurimin e një ambienti të qëndrueshëm dhe të sigurt për përdoruesit dhe bizneset. **Demonstruar Ekspertizë dhe Aftësi:** Certifikatat për RHEL, si Red Hat Certified System Administrator (RHCSA) dhe Red Hat Certified Engineer (RHCE), janë një provë e qartë e njohurive dhe aftësive tuaja në administrimin e serverëve RHEL. Këto certifikata janë të njohura dhe të pranuar ndërkombëtarisht dhe ndihmojnë në vërtetimin e ekspertizës të OE në këtë fushë. **Përditësimi me Teknologjitë e Reja:** RHEL është një sistem operativ që zhvillohet dhe përmirësohet vazhdimisht. Certifikimi ndihmon që profesionistët të mbajnë njohuritë e tyre të përditësuara me risitë dhe ndryshimet më të fundit në RHEL, duke siguruar që OE të jenë të përgatitur për teknologjitë dhe praktikën më të reja. **Siguria dhe Menaxhimi i Mjedisit:** Administrimi i serverëve RHEL përfshin menaxhimin e sistemeve dhe të dhënave të ndjeshme. Certifikimi ndihmon që profesionistët e OE të kuptojnë dhe të zbatojnë praktikën më të mira për sigurimin e serverëve, mbrojtjen nga kërcënimet e sigurisë dhe menaxhimin efektiv të burimeve. **Standardizimi dhe Cilësia e Shërbimeve:** Certifikimi



ndihmon në ruajtjen e standardeve të larta të cilësisë në administrimin e serverëve RHEL. Kjo I siguron AK-se që praktikat më të mira dhe standardet ndërkombëtare ndiqen për të siguruar performancën dhe qëndrueshmërinë e serverëve.

4. 1 (një) punonjës të certifikuar për administrim të serverave Windows ose ekuivalente.

**Argumentim:** Për të garantuar mirëmbajtjen e hardware-t (serverave) me sistem operimi Windows, në skuadër nevojitet një punonjës i certifikuar në administrimin e tyre. Certifikimi për administrim të serverave Windows është i rëndësishëm për disa arsye që ndihmojnë në përmirësimin e aftësive profesionale dhe ndihmojnë në sigurimin e një ambienti të qëndrueshëm dhe të sigurt për OSHEE Group sh.a. **Demonstruar Njohuri dhe Aftësi:** Certifikimet, si Microsoft Certified: Windows Server Administrator, janë prova të qarta që tregojnë njohuritë dhe aftësitë në administrimin e serverëve Windows. Këto certifikata janë një mënyrë e mirë për të treguar ekspertizën e OE në një mënyrë të standardizuar dhe të pranuar globalisht. **Përditësimi me Teknologjitë e Reja:** Teknologjitë dhe versionet e Windows Server vazhdimisht zhvillohen. Certifikimet ndihmojnë që profesionistët të mbajnë njohuritë e tyre të përditësuara me risitë dhe përmirësimet më të fundit të sistemit operativ, duke siguruar që ata të jenë të përgatitur për sfidat dhe kërkesat e reja. **Siguria dhe Mbrojtja e Sistemit:** Administrimi i serverëve përfshin menaxhimin e informacionit dhe të dhënave të ndjeshme. Certifikimet ndihmojnë në sigurimin që profesionistët e OE janë të aftë të krijojnë dhe ruajnë një ambient të sigurt për mbrojtjen nga kërcënimet e mundshme dhe nga humbjet e të dhënave. **Standardizimi dhe Cilësia e Shërbimeve:** Certifikimi ndihmon në ruajtjen e standardeve të larta të cilësisë dhe efikasitetit në administrimin e serverëve. Kjo siguron që praktikat më të mira dhe standardet ndërkombëtare ndiqen për të siguruar performancën dhe qëndrueshmërinë e serverëve të OSHEE Group sh.a. **Kredibiliteti dhe Besueshmëria:** Certifikatat e njohura, si ato nga Microsoft, ndihmojnë në ndërtimin e besimit me Autoritetin Kontraktor, duke treguar se OE ka një nivel të lartë të njohurish dhe aftësish në administrimin e serverëve Windows. **Përmirësimi i Efikasitetit Operacional:** Profesionistët e certifikuar zakonisht janë më të aftë në zgjidhjen e problemeve dhe optimizimin e performancës së serverëve. Kjo ndihmon në përmirësimin e efikasitetit operacional dhe zvogëlimin e kohës së papritur dhe të ndalimeve.

5. Te pakten 2 (dy) të certifikuar për menaxhim baze të dhenash me minimumi 5 vjet eksperience ose ekuivalent.

**Argumentim:** Certifikatat në menaxhimin e bazave të të dhënave, edhe për ata që kanë përvojë prej 5 vjetësh ose më shumë, janë të rëndësishme për disa arsye: **Vlerësimi dhe Njohja e Aftësive:** Certifikatat ndihmojnë në verifikimin e njohurive dhe aftësive specifike që një individ ka në menaxhimin e bazave të të dhënave. Ato ofrojnë një mënyrë të standardizuar për të demonstruar ekspertizën dhe për të krahasuar aftësitë me ato të profesionistëve të tjerë në fushë. **Përditësimi i Njohurive:** Teknologjitë dhe praktikat e menaxhimit të bazave të të dhënave evolucionojnë vazhdimisht. Certifikatat ndihmojnë që individët të mbajnë njohuritë e tyre të përditësuara me teknologjitë dhe standardet më të fundit në industrinë e IT-së. **Përgjegjësia dhe Siguria:** Menaxhimi i bazave të të dhënave shpesh përfshin trajtimin e të dhënave të ndjeshme dhe kritike për biznesin. Certifikatat sigurojnë që profesionistët kanë njohuri të mjaftueshme për të siguruar që bazat e të dhënave të jenë të mbrojtura dhe të menaxhuara në mënyrë të sigurt. **Konsistenca**

*dhe Standardizimi: Certifikatat ndihmojnë në ruajtjen e standardeve të larta dhe të konsoliduara në industri. Ato sigurojnë që profesionistët ndjekin praktika të njohura dhe të miratuara, duke kontribuar në cilësinë dhe efikasitetin e menaxhimit të bazave të të dhënave.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuarçdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Termet e References dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga grupi i punes i ngritur me urdher te posacem nga titullari, duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per sherbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

**SHENIM: ne respektim te nenit 36 te LPP sqarojme se kudo ku perdoret/përmendet, markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.**